



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Nr. 566/5 Prot.

Tiranë, më 2/7/2014

REKOMANDIM

Nr 62, datë 02/7/2014

Mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr. 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit "KLAN TV", Tiranë.

KONSTATOVA

Në zbatim të Urdhrit nr. 47 datë 27.03.2014 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është kryer inspektimi administrativ pranë kontrolluesit "KLAN TV" me objekt: "Verifikimi i ankesës së znj. D.M drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, e cila lidhet me "përdorimin e të dhënave të saja personale pa dhënien e pëlqimit, nga Klan TV, gjatë transmetimit të show-ut televiziv "E diela Shqiptare" të datës 02.11.2013".

"KLAN TV" në kuptim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, është kontrollues privat i cili kryen aktivitetin e tij në fushën e medias audiovizive. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij mbledh, përpunon dhe ruan të dhëna personale kryesisht në rrugë manuale, si dhe nëpërmjet sistemeve e programeve elektronike. Inspektimi administrativ është iniciuar duke u bazuar në ankesën e paraqitur pranë Autoritetit të Komisionerit lidhur me faktin që në rubrikën "Shihemi në Gjyq" të emisionit "E diela Shqiptare" të datës 02.11.2013, janë përdorur të dhëna personale dhe janë publikuar fakte apo rrethana nga jeta e ankueses (D.M), pa marrë pëlqimin e kësaj të fundit.

Janë vërtetuar pretendimet e ankueses se personi i paraqitur në seancën e ndërmjetësimit nuk është personi me initiale D.M (pala ankuese) por dikush tjetër, gjithashtu u vërtetua se kjo seancë ndërmjetësimi ndodhet e publikuar edhe në rrjetet sociale YOUTUBE dhe FACEBOOK. Publikimi i të dhënave personale dhe fakteve e rrethanave nga jeta e palës ankuese (D.M) duke e bërë atë të identifikueshme, përben shkelje të privatësisë të ankueses.

Sa më lart rezulton se nuk është marrë pëlqimi i ankueses për publikimin e të dhënave të saj personale dhe në këtë rast nga ana e TV Klan në rolin e kontrolluesit të të dhënave personale, nuk është zbatuar neni 6/1/a i ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 9, datë 15.09.2010 "Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive", i

ndryshuar (pika 9 Kreut I) të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Kushdo që përpunon të dhëna personale për qëllime gazetarie, së pari duhet të respektoj të drejtën e individit për të mbrojtur të dhënat personale të tij, duhet të respektohet parimi se “*çdo person ka të drejtë për respektimin e jetës së tij apo të saj private dhe familjare, shtëpinë, shëndetin dhe korrespondencën*”.

Detyrimi kryesor i juaj si kontrollues është përpunimi i të dhënave personale vetëm nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin, përpunimi i të dhënave pa marrjen e pëlqimit është i mundur vetëm në rastet e parashikuara në nenin 6 të ligjit “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*” i ndryshuar. Marrja e pëlqimit është kusht i rëndësishëm ligjor për përpunimin e të dhënave personale, pëlqimi duhet të jepet i qartë dhe specifik, ai duhet të jetë i shprehur me shkrim dhe duhet të jepet para mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale.

Është vërtetuar se rastin (konflikt pronësie) e ka paraqitur daja i ankueses (pa dijeninë e kësaj të fundit) i cili ka diskutuar me drejtuesen e rubrikës “Shihemi në Gjyq” dhe i ka prezantuar një person tjetër në cilësinë e mbesës (ankueses). Nga ana e kontrolluesit nuk është bërë verifikimi i pjesëmarrësve në seancat e ndërmjetësimit dhe nuk është nënshkruar ndonjë deklaratë për identifikimin e palëve. Mungesa e një procedure verifikimi paraprak të identitetit dhe saktësisë së të dhënave personale të palëve pjesëmarrëse në procesin e ndërmjetësimit, është në kundërshtim me nenin 5/1/ç të ligjit “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*” i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 9, datë 15.09.2010 “*Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive*”, i ndryshuar (pika 5 Kreut I) të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Në keto kushte duhet të merren masa të menjëhershme, që për çdo çështje ndërmjetësimi të aplikohet një procedurë verifikimi paraprak i identitetit dhe saktësisë së të dhënave personale të palëve pjesëmarrëse në proces, duke patur parasysh që edhe ndërmjetësit në kuptim të ligjit “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*” i ndryshuar janë kontrollues.

Informimi në kohën e duhur dhe sa më i saktë i subjekteve të të dhënave personale nga Institucioni juaj në drejtim të respektimit të privatësisë dhe përpunimit në respekt të ligjit i të dhënave personale i parashikuar në nenin 18 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*” i ndryshuar, nuk është realizuar. Informimi i subjekteve të të dhënave personale nga kontrolluesit është një detyrim shumë i rëndësishëm në drejtim të respektimit të privatësisë dhe përpunimit në respekt të ligjit, i të dhënave personale. Informacioni duhet të jepet i saktë dhe sa më shpejtë që të jetë e mundur, informimi mund të jepet në kohën e grumbullimit të të dhënave. Në këtë informim duhet të përfshihen mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, masat e sigurisë, ruajtja e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë. Një mënyrë shumë efektive është informimi i subjekteve të të dhënave personale në faqen tuaj në internet në një rubrikë të veçantë të emëruar “*politikat e privatësisë*” (paketë rregullash).

Nga ana juaj si kontrollues nuk janë hartuar rregulla për mbledhjen, përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Hartimi i rregulloreve është një pjesë e rëndësishme e masave të sigurisë që në tërësi zbaton kontrolluesi, prandaj është shumë e rëndësishme që ju si kontrollues të hartoni rregullore të veçantë për të përcaktuar rregulla për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale. Në rregullore duhet të përcaktohen nivelet e përdoruesve, të drejtat e tyre, aksesit etj, si dhe rregulla lidhur me konfidencialitetin e të dhënave personale sipas kërkesave të neneve 27 dhe 28 të ligjit nr.

9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar. Përmirësimi dhe zbatimi i rregullave është një siguri më shumë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave, gjatë përpunimit të të dhënave personale që kryeni ju si kontrollues.

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative :

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të nenit 5/1/c të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, për çdo çështje ndërmjetësimi të aplikohet një procedurë verifikimi paraprak e identitetit dhe saktësisë së të dhënave personale të palëve pjesëmarrëse në proces.

2. Në zbatim të nenit 6/1/a të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar:

- Për çdo çështje ndërmjetësimi duhet të merret pëlqimi paraprak dhe në formë shkresore i palëve pjesëmarrëse në seancat e ndërmjetësimit.
- Të fshihet publikimi i seancës ndërmjetësuese nga të gjitha mediat dhe rrjetet sociale (Youtube dhe Facebook).

3. Në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar:

- Të informohen paraprakisht subjektet e të dhënave (palët në seancat e ndërmjetësimit) mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave, për të drejtën për akses, të drejtën për korrigjim të të dhënave personale të tyre dhe konfidencialitetin e të dhënave.
- Në faqen tuaj në internet të publikohen në një rubrikë të veçantë “politikat e privatësisë” (paketë rregullash), me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave personale, si dhe të përfshihen kushtet e kriteret që reflektojnë parimet e përpunimit të ligjshëm dhe të drejtë të të dhënave personale. Disa nga këto parime do t’i gjeni në Opinionin “Mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Faqen e Internetit të Kontrolluesve Publik dhe Privat” publikuar në faqen zyrtare të KMDP-së www.kmdp.al.

4. Në zbatim të neneve 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, të hartohet një rregullore të brendshme lidhur me ruajtjen e sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave personale, ku të parashikohen masa konkrete sigurie, detyrimet e kontrolluesit dhe përpunuesit dhe të drejtat e subjekteve të të dhënave. Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare www.kmdp.al, si dhe ofrojmë asistencën tonë.

5. Kryerja e këtyre detyrimeve të rëndësishme të realizohet brenda një afati kohor prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh, nga momenti i marrjes dijeni të këtij Rekomandimi.

6. Për plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

7. Me kalimin e këtij afati në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, sipas të cilit.. "Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

KOMISIONERI

The image shows a circular official stamp in blue ink. The text around the perimeter of the stamp reads "REPUBLIKA E SHQIPËRIE" at the top and "KOMISIONERI PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE" at the bottom. In the center of the stamp, there is a handwritten signature in blue ink that appears to be "Flora Çabej". Below the signature, the word "KOMISIONERI" is printed in bold, black capital letters.